



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KOMUNA E OBILIQIT**  
**OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC**



Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq  
 Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë

Datë/Data/Date:	10.04.2026
Për / Za / To:	z. Sami Ahmeti, Kryesuesi i kuvendi
Nga/ Od/ From:	z. Halil Thaçi, Kryetar i komunës
Tema / subjekat / subject:	Kërkesë për mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit komunal



Të nderuar/a,

Duke u mbështetur në Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, dhe Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të komunës, nenit 12 pika 1, e Rregullores komunale për transportin rrugorë në territorin e komunës së Obiliqit me nr.I-117 data 29.10.2015.

Kërkojmë nga ana e juaj që në seancën e radhës të Kuvendit komunal të jete si rendë dite:

- Plani i rrjetit të linjave dhe subvencionimin i transportit publik për udhëtarët në territorin e komunës së Obiliqit.

Me respekt!

Duke u bazuar në Vendimin Nr. 02-020-01-4822-26, datë 16.02.2026, është formuar Komisioni për përgatitjen e linjave dhe itinerareve të transportit publik në Komunën e Obiliqit, ku është realizuar analiza tekniko-inxhinierike dhe organizimi i linjave të transportit publik nga vendbanimet e Komunës së Obiliqit drejt Prishtinës.

Ky raport paraqet metodologjinë e punës së komisionit, strukturimin e itinerareve, përcaktimin e orareve të qarkullimit dhe logjikën e intervaleve mbrojtëse ndërmjet nisjeve, me qëllim të mbulimit sa më të mirë të territorit dhe shpërndarjes funksionale të shërbimit gjatë ditës.

### **Organizimi i linjave**

Organizimi i rrjetit të linjave të transportit publik është realizuar me qëllim të përmbushjes së këtyre objektivave kryesore:

- Sigurimi i mbulueshmërisë së plotë të territorit të Komunës së Obiliqit.
- Rritja e efikasitetit të shërbimit të transportit publik të udhëtarëve.
- Shmangia e mbivendosjes së nisjeve në raport me kërkesën e pasagjerëve.
- Garantimi i intervaleve mbrojtëse ndërmjet autobusëve përmes një organizimi racional të orareve.
- Përmirësimi i lidhjes funksionale ndërmjet Obiliqit dhe Prishtinës.

### **Metodologjia e përgatitjes së orareve**

Përgatitja e linjave dhe orareve të transportit publik është realizuar mbi bazën e analizës tekniko-inxhinierike, duke ndjekur një qasje të strukturuar dhe të harmonizuar me parimet e planifikimit të transportit publik urban dhe ndërrurban.

Në fazën fillestare është realizuar identifikimi i plotë i vendbanimeve në territorin e Komunës së Obiliqit, përfshirë fshatrat dhe zonat me densitet më të lartë të banimit. Në këtë fazë është analizuar shpërndarja gjeografike e popullsisë, distancat nga akset kryesore rrugore si dhe lidhshmëria funksionale me qendrën komunale dhe me drejtimin kryesor të lëvizjes drejt Prishtinës.

Në fazën e dytë është bërë përcaktimi i akseve rrugore kryesore, duke përzgjedhur korridoret që sigurojnë qarkullim të sigurt, kapacitet të mjaftueshëm rrugor dhe kohë optimale të udhëtimit. Linjat janë projektuar në mënyrë që të mbulojnë maksimalisht vendbanimet përgjatë këtyre akseve, duke shmangur devijimet e panevojshme që do të ndikonin negativisht në kohën e udhëtimit dhe në efikasitetin operacional të transportit publik.

Në fazën e tretë është realizuar dimensionimi i nisjeve, përkatësisht frekuencave të qarkullimit, bazuar në kërkesën reale të banorëve dhe nevojat për mobilitet. Vëmendje e veçantë i është kushtuar orëve të pikut gjatë mëngjesit dhe pasdites, kur kërkesa për transport është më e lartë. Në

këtë mënyrë janë përcaktuar intervale kohore të balancuara ndërmjet nisjeve, me qëllim shmangien e mbivendosjes së autobusëve dhe garantimin e intervaleve mbrojtëse. Në përfundim të këtij procesi është hartuar itinerari përfundimtar për secilën linjë, ku janë përcaktuar drejtimi i qarkullimit, pikat e ndaljes, koha e kalimit në pikën referente si dhe lidhja funksionale me rrjetin kryesor të transportit.

Kjo metodologji siguron një organizim racional dhe të qëndrueshëm të shërbimit të transportit publik, të mbështetur në analiza teknike të inxhinierisë së transportit dhe në nevojat reale të qytetarëve.

### **Përcaktimi i pikës referente kohore**

Për sinkronizimin e orareve të qarkullimit është përcaktuar një pikë referente kohore. Si pikë matëse e kohës mbrojtëse si reference është caktuar:

#### **Vend ndalja te QKMF – Obiliq**

Kjo pikë është përdorur për:

- Matjen e intervaleve kohore ndërmjet nisjeve të autobusëve
- Kontrollin e mbivendosjes së linjave
- Ruajtjen e intervaleve mbrojtëse ndërmjet mjeteve të transportit publik

### **Analiza e intervaleve (Headway)**

Nga analiza e tabelës së përgatitur rezulton se operimi i transportit publik është planifikuar në intervalin kohor nga ora **06:00 deri në 23:00**.

Frekuenca më e lartë e nisjeve është planifikuar gjatë **orëve të pikut**, respektivisht:

- 07:00 – 09:00
- 15:00 – 18:00

Intervali mesatar ndërmjet nisjeve në segmentet kryesore të rrjetit është **15–30 minuta**, ndërsa në orët jashtë pikut intervali është më i madh, në përputhje me nivelin e kërkesës.

Në organizimin e orareve janë aplikuar intervale mbrojtëse kohore me qëllim të shmangies së:

- kolonave të autobusëve
  - konflikteve në stacionin e QKMF-së
  - ngarkesës së panevojshme të trafikut në njësi kohore
- Ky organizim mundëson shpërndarje më të balancuar të shërbimit gjatë gjithë ditës.

### **Vlerësimi teknik inxhinierik i zgjidhjes funksionale të transportit urban publik**

Zgjidhja e propozuar karakterizohet nga:

- organizimi radial i linjave drejt Prishtinës
- shfrytëzimi racional i flotës së autobusëve

- optimizimi i kohës së qarkullimit (turnaround time)
  - rritja e besueshmërisë së orarit për pasagjerët
  - lehtësia në monitorim dhe kontroll operativ të sistemit
- Përdorimi i vendndaljes të QKMF si pikë referente paraqet zgjidhje funksionale, pasi:
- përfaqëson një nyje urbane me qasje të mirë rrugore
  - mundëson kontroll vizual dhe operacional të qarkullimit
  - ka pozicion qendror në rrjetin e linjave të transportit publik

### **Linjat dhe segmentet e itinerareve të transportit publik**

Në kuadër të analizës dhe planifikimit të rrjetit të transportit publik janë identifikuar dhe projektuar linjat që lidhin vendbanimet e territorit të Komunës së Obiliqit me qendrën kryesore urbane të Prishtinës.

Linjat e përfshira në këtë rrjet të transporti janë:

- Linja **Obiliq – Prishtinë**,
- Linja **Obiliq – Fushë Kosovë – Prishtinë**,
- Linja **Hamidi – Plemetin – Obiliq – Prishtinë**,
- Linja **Hade e Re – Mazgit – Obiliq – Prishtinë**,
- Linja **Bakshi – Raskovë – Obiliq – Prishtinë**,
- Linja **Breznicë – Babimoc – Obiliq – Prishtinë**,
- Linja **Kozaricë – Babimoc – Obiliq – Prishtinë**,
- Linja **Graboc – Siboc – Obiliq – Prishtinë**,
- Linja **Dardhishtë – Prishtinë**,

Të gjitha linjat janë konceptuar sipas modelit **radial të organizimit të transportit publik**, ku itineraret koncentrohen drejt qendrës urbane të Prishtinës. Për secilën linjë janë llogaritur me saktësi kilometrat e itinerarit nga vendndalja (origjina) deri te destinacioni përfundimtar, me qëllim planifikimin e saktë të kohës së qarkullimit, frekuencës së nisjeve dhe menaxhimit operacional të shërbimit.

#### **Shtojca nr.1**

Secila nga linjat e propozuara duhet të ketë itinerar, si në vijim:

##### **➤ Linja, Nr:2 Obiliq – Prishtinë**

Nisja nga Obiliqi i Vjetër, qendra e Obiliqit, vazhdon djathtas në magjistralen Mitrovicë – Prishtinë, rruga “Bill Kllintoni”, te Fakulteti Filozofik, rruga “Agim Ramadani” dhe përfundon afër fakultetit Teknik.

**Vend ndaljet:**

<b>Relacioni: Obiliq - Prishtinë, dhe anasjelltas</b>	
<b>Nisja</b>	<b>Kthimi</b>
<b>Vend ndalja</b>	<b>Vend ndalja</b>
Obiliq i Vjetër	Obiliq i Vjetër
Rrethi Obiliq	Rrethi Obiliq
QKMF - Obiliq	QKMF - Obiliq
Trafo	Trafo
Subotiq	Subotiq
QKMF - KEK	QKMF - KEK
Shkabaj	Shkabaj te rrethi
Magjistrale	Shkabaj
Lakrishtë	Magjistrale
Dardani	Lakrishtë
Nënkalimi	Dardani
F. Filozofik	Nënkalimi
M. Studentëve	F. Filozofik
F. Teknik	M. Studentëve
	F. Teknik

➤ **Linja Obiliq – Fushë Kosovë**

Nisja nga Obiliqi: qendra e Obiliqit, vazhdon në rrugën Hasan Prishtina, QKMF-KEK, djathtas në rrugën, Hazir Merlaku te posta/rrethi ne Fushe Kosove dhe përfundon afër interexi.

<b>Relacioni: Obiliq - Fushë Kosovë dhe anasjelltas</b>	
<b>Nisja</b>	<b>Kthimi</b>
<b>Vend ndalja</b>	<b>Vend ndalja</b>
Rrethi Obiliq	Rrethi Obiliq
QKMF - Obiliq	QKMF - Obiliq
Trafo	Trafo
Subotiq	Subotiq
QKMF - KEK	QKMF - KEK
Te Mexhuanët	Te Mexhuanët
Te Kutllofcët	Te Kutllofcët
Te Shkolla	Te Shkolla

Te Trafoja - Na	Te Trafoja - Na
Te Posta F.K	Te Posta F.K
Te Rrethi F.K	Te Rrethi F.K
SH.F Mihal Gr	SH.F Mihal Gr
Bau Market F.K	Bau Market F.K
Te Interex F.K	Te Interex F.K

➤ **Linja, me fshatrat e K. Obiliqit**

Nisja nga fshatrat e Obiliqit, Obiliq: vazhdon djathtas në magjistralen Mitrovicë – Prishtinë rruga “Bill Kllintoni”, majtas në rrugën Tirana, djathtas në rrugën Galibardi dhe përfundojnë prapa Pallatit të Rinisë.

<b>Relacioni: Graboc-Sibofc-Obiliq-Prishtinë, dhe anasjelltas</b>	
<b>Nisja</b>	<b>Kthimi</b>
<b>Vend ndalja</b>	<b>Vend ndalja</b>
Graboc te mulliri	Graboc te mulliri
Graboc stacioni I	Graboc stacioni I
Graboc stacioni II	Graboc stacioni II
Graboc stacioni III	Graboc stacioni III
Shipitullë-Çeshmja	Shipitullë-Çeshmja
Sibofc - Nicat	Sibofc - Nicat
Sibofc - Shkolla	Sibofc - Shkolla
Sibofc-Permendorja	Sibofc-Permendorja
Lajthishtë	Lajthishtë
Palaj	Palaj
QKMF - Obiliq	QKMF - Obiliq
Trafo	Trafo
Subotiq	Subotiq
QKMF - KEK	QKMF - KEK
Shkabaj te rrethi	Shkabaj te rrethi
Magjistrale Pr	Shkabaj
Lakrishtë	Magjistrale Pr
Pallati i Rinisë	Lakrishtë
	Pallati i Rinisë

<b>Relacioni: Hamidi - Plemetin - Obiliq - Prishtinë, dhe anasjelltas</b>	
<b>Nisja</b>	<b>Kthimi</b>
<b>Vend ndalja</b>	<b>Vend ndalja</b>
Hamidi Lapidari	Hamidi Lapidari
Te Ura	Te Ura
Te Xhamia	Te Xhamia
TCB	TCB
Rr. Isa Boletini	Rr. Isa Boletini
Rrethi Obiliq	Rrethi Obiliq
QKMF - Obiliq	QKMF - Obiliq
Trafo	Trafo
Subotiq	Subotiq
QKMF - KEK	QKMF - KEK
Shkabaj te rrethi	Shkabaj te rrethi
Magjistrale Pr	Shkabaj
Lakrishtë	Magjistrale Pr
Pallati i rinisë	Lakrishtë
	Pallati i rinisë

<b>Relacioni: Dardhishtë - Prishtinë, dhe anasjelltas</b>	
<b>Nisja</b>	<b>Kthimi</b>
<b>Vend ndalja</b>	<b>Vend ndalja</b>
Dardhishtë	Dardhishtë
Te shkolla Dardhishtë	Te shkolla Dardhishtë
Kutllofcët	Kutllofcët
Mexhuanët	Mexhuanët
QKMF - KEK	QKMF - KEK
Shkabaj te rrethi	Shkabaj te rrethi
Magjistrale Pr	Shkabaj
Lakrishtë	Magjistrale Pr
Pallati i Rinisë	Lakrishtë
	Pallati i Rinisë

<b>Relacioni: Breznicë – Prishtinë dhe anasjelltas</b>	
<b>Nisja</b>	<b>Kthimi</b>
<b>Vend ndalja</b>	<b>Vend ndalja</b>
Breznicë rr Hazir Muli	Breznicë rr Hazir Muli

Rr Rudina - te Ura	Rr Rudina - te Ura
Rr. Kështjella e UÇK	Rr. Kështjella e UÇK
Br. Te Shkolla	Br. Te Shkolla
Te fabrika rr. Rudina	Te fabrika rr. Rudina
Lagja Koskovikët	Lagja Koskovikët
Ba-moc Lagja Berisha	Ba-moc Lagja Berisha
Lagja Mehmeti	Lagja Mehmeti
Te Xhamia	Te Xhamia
Rruga Lahu	Rruga Lahu
Rrethi Babimoc	Rrethi Babimoc
Te shkolla	Te shkolla
Te Ura	Te Ura
Babimoc M2	Babimoc M2
Millosevë I M2	Millosevë I M2
Millosevë II M2	Millosevë II M2
Millosevë III M2	Millosevë III M2
Rr. Llapi	Rr. Llapi
Obiliq i Vjetër	Obiliq i Vjetër
Rrethi Obiliq	Rrethi Obiliq
QKMF - Obiliq	QKMF - Obiliq
Trafo	Trafo
Subotiq	Subotiq
QKMF - KEK	QKMF - KEK
Shkabaj te rrethi	Shkabaj te rrethi
Magjistrale Pr	Shkabaj
Lakrishtë	Magjistrale Pr
Pallati i Rinisë	Lakrishtë
	Pallati i Rinisë

<b>Relacioni: Kozaricë - Babimoc - Obiliq – Pr dhe anasjelltas</b>	
<b>Nisja</b>	<b>Kthimi</b>
<b>Vend ndalja</b>	<b>Vend ndalja</b>
Koz. Te Shkolla	Koz. Te Shkolla
Te xhamia	Te xhamia
Te Permendorja	Te Permendorja
Rr. Kalaja e UÇK	Rr. Kalaja e UÇK
Lagja Hoxha	Lagja Hoxha
Rr. Kamer Beka	Rr. Kamer Beka
Br. Te Shkolla	Br. Te Shkolla

Te fabrika rr. Rudina	Te fabrika rr. Rudina
Lagja Koskovikët	Lagja Koskovikët
Ba-moc Lagja Berisha	Ba-moc Lagja Berisha
Lagja Mehmeti	Lagja Mehmeti
Te Xhamia	Te Xhamia
Rruga Lahu	Rruga Lahu
Rrethi Babimoc	Rrethi Babimoc
Babimoc te shkolla	Te shkolla
Babimoc te Ura	Te Ura
Babimoc M2	Babimoc M2
Millosevë I M2	Millosevë I M2
Millosevë II M2	Millosevë II M2
Millosevë III M2	Millosevë III M2
Rr. Llapi	Rr. Llapi
Obiliq i Vjetër	Obiliq i Vjetër
Rrethi Obiliq	Rrethi Obiliq
QKMF - Obiliq	QKMF - Obiliq
Trafo	Trafo
Subotiq	Subotiq
QKMF - KEK	QKMF - KEK
Shkabaj te rrethi	Shkabaj te rrethi
Magjistrale Pr	Shkabaj
Lakrishtë	Magjistrale Pr
Pallati i Rinisë	Lakrishtë
	Pallati i Rinisë

<b>Relacioni Hade e Re - Ob – Prishtinë dhe anasjelltas</b>	
<b>Nisja</b>	<b>Kthimi</b>
<b>Vend ndalja</b>	<b>Vend ndalja</b>
Hade e Re	Hade e Re
Hade e Re II	Hade e Re II
Mazgit - Nënkalimi I	Mazgit - Nënkalimi I
Mazgit - Rr H.Bici	Mazgit - Rr H.Bici
Mazgit-Rr.H.B Shkolla	Mazgit-Rr.H.B Shkolla
Mazgit - L. Bregovina	Mazgit - L. Bregovina

Mazgit te K. Fëmijëve	Mazgit te K. Fëmijëve
M. Epërm te Shkolla	M. Epërm te Shkolla
QKMF - Obiliq	QKMF - Obiliq
Trafo	Trafo
Subotiq	Subotiq
QKMF - KEK	QKMF - KEK
Shkabaj te Rrethi	Shkabaj te rrethi
Magjistrale Pr	Shkabaj
Lakrishtë	Magjistrale Pr
Pallati i Rinisë	Lakrishtë
	Pallati i Rinisë

<b>Relacioni: Bakshi - Raskovë - Ob - Pr, dhe anasjelltas</b>	
<b>Nisja</b>	<b>Kthimi</b>
<b>Vend ndalja</b>	<b>Vend ndalja</b>
Bakshi te xhamia	Bakshi te xhamia
Bakshi te ura	Bakshi te ura
Bakshi Rr. Kryesore	Bakshi Rr. Kryesore
Raskovë te Xhamia	Raskovë te Xhamia
Raskovë M2	Raskovë M2
Millosevë I M2	Millosevë I M2
Millosevë II M2	Millosevë II M2
Millosevë III M2	Millosevë III M2
Rr. Llapi	Rr. Llapi
Obiliq i Vjetër	Obiliq i Vjetër
Rrethi Obiliq	Rrethi Obiliq
QKMF - Obiliq	QKMF - Obiliq
Trafo	Trafo
Subotiq	Subotiq
QKMF - KEK	QKMF - KEK
Shkabaj te rrethi	Shkabaj te rrethi
Magjistrale Pr	Shkabaj
Lakrishtë	Magjistrale Pr
Pallati i Rinisë	Lakrishtë
	Pallati i Rinisë

## **Përfundim**

Organizimi i linjave dhe itinerareve të transportit publik është realizuar mbi baza profesionale të inxhinierisë së komunikacionit, duke respektuar parimet e planifikimit të transportit publik, sigurinë në komunikacion, intervalet mbrojtëse dhe balancimin e shërbimit me kërkesën e pasagjerëve.

Zgjidhja e propozuar siguron funksionim të qëndrueshëm dhe efikas të transportit publik ndërmjet Obiliqit dhe Prishtinës, duke kontribuar në përmirësimin e mobilitetit të transportit të qytetarëve dhe në organizimin më racional të qarkullimit.